


Ministri i Drejtësisë  
Për Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë  
Procedura e këtij kushtetutës është e lartë  
Këtia kushtetuta e kushtetutës  
është tashmë e vlefshme

KUVENDI  
NR 2181 DATE 28.06.18



KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr.

Prot.

Tiranë, më, 6 2018

Lënda: Kërkesë për shtesë personeli në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit

KRYETARIT TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS  
Z.Gramoz RUCI

KRYETARIT TË KOMISIONIT TË LIGJEVE TË KUVENDIT  
Z. Ulsi Manja

MINISTRIT TË FINANÇËS DHE EKONOMISË  
Z. Arben Ahmetaj

MINISTRIT TË DREJTËSISË  
Znj. Etilda Gjonaj

Për dijeni: SEKRETARIT TË PËRGJITHSHËM TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE  
Z. Engjell Agaçi

Tiranë

Të nderuar,

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është organ i ri kushtetues, me mandat 5-vjeçar, i krijuar me ndryshimet e reja të Kushtetutës, si pjesë e paketës për Reformën në Drejtësi, për krijimin e një sistemi gjyqësor të pavarur dhe profesional të çliruar nga korruzioni.

Veprimtaria e Komisionit bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe në ligjin nr.84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Komisioni kryen procedurat e rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit në 4 trupa gjykuese, të përbërë me tre anëtarë secili.

Organika dhe klasifikimi i pagave të Komisionit rregullohet sipas Vendimit të Kuvendit nr. 93/2017 “Për miratimin e strukturës organizative, organikës dhe klasifikimit të pagave të personelit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit”.

1.Organika ka në përbërje 12 këshilltarë juristë dhe 4 këshilltarë ekonomistë. Pas shpërndarjes së çështjeve në trupat gjykuese, një këshilltar ekonomik duhet të punojë njëkohësisht me 3 këshilltarë juristë për tri çështje të ndryshme, pra, të mbulojë 3-fishin e punës së këtyre të fundit.

Duke parë ngarkesën e madhe dhe voluminoze në mbulimin e dosjeve të subjekteve të rivlerësimit, kohë e limituar që ka institucioni ynë për realizimin e misionit, objektivave dhe detyrave të caktuara nga Kushtetuta, e vlerësojmë si tepër të rëndësishme rritjen e numrit të personelit me: **8 këshilltarë ekonomistë**, duke e çuar numrin e tyre në 12 këshilltarë ekonomistë.

2.Gjithashtu, në përbërjen e institucionit sot punojnë vetëm 3 përkthyes, të cilët duhet të sigurojnë realizimin e një numri të madh faqesh përkthimi brenda një kohe të shkurtër dhe me cilësi të lartë, kërkesa këto të diktuarë nga natyra e veprimtarisë së Komisionit. Duke marrë në konsideratë rëndësinë e veçantë që ka përkthimi për komunikimin e akteve dhe gjithë dokumentacionit te partnerët e huaj, kërkojmë **shtesë personeli me 2 përkthyes**, për të arritur në total në 5 përkthyes.

3.Në strukturën e Komisionit është parashikuar vetëm 1 specialist protokoll/arkive. Gjatë kësaj periudhë të parë të punës, është vënë re se specialisti është përballur me një volum të lartë pune që rrjedh nga sasia e madhe e dokumentacionit hyrës dhe dalës që duhet të pranohet dhe të shpërndahet në trupat gjykuese. Më konkretisht, vetëm gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2018 numri render i protokollimeve ka arritur mbi 5 mijë.

Duhet theksuar se një shkresë dalëse me anë të së cilës kërkohet informacion, dërgohet në 36 drejtime të ndryshme (ku përfshihen bankat, degët e tatimeve, zyrat vendore të regjistrimeve të paluajtshme, ILDKPKI, Prokuroritë, degët e ALUIZNI-it etj.) Sipas kërkesave të dërgimit postar, në çdo zarf duhet të shënohet adresa e marrësit dhe të plotësohet fleta e lajmërim-marrjes, për të vërtetuar marrjen në dorëzim të tij.

Këto kërkesa kanë bërë që specialisti i protokollit të punojë pothuajse përditë mbi orarin zyrtar të punës, madje edhe ditët e shtuna apo të pushimeve zyrtare. Në shumë raste specialisti është ndihmuar nga punonjës të tjera të Komisionit, të cilët kanë krijuar vakum në punën e tyre të përditshme.

Ngarkesës së përditshme në këtë sektor, i shtohet edhe mbajtja e postës sekrete, që ka specifika të veçanta për ruajtjen dhe përpunimin e dokumentacionit, dhe kërkon më shumë përqendrim, përgjegjësi dhe përgjegjshmëri të lartë.

Duke pasur parasysh sa më sipër, kërkojmë shtesë në personel me **2 specialistë shtesë protokoll/arkive**.

**4.** Në strukturën e Komisionit janë parashikuar vetëm 4 specialistë të sekretarisë gjyqësore, një për secilën nga katër trupat. Nga përvoja e deritanishme kemi konstatuar nevojën e më shumë specialistëve të sekretarisë veçanërisht për mbarëvajtjen e procesit të apelimit të vendimeve të Komisionit në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit. Kjo për arsy se pse procedura e dërgimit të vendimeve të ankimuara në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit është e ngjeshur dhe duke marrë parasysh volumin e faqeve të dokumentave (më shumë se një mijë faqe për një çështje) të cilat inventarizohen, numërohen dhe siglohen, kërkon një kohë të gjatë dhe më shumë burime njerëzore për të respektuar të gjitha kërkesat dhe afatet ligjore që lidhen me ankimin. Për këtë arsy, kërkojmë një **shtesë prej 2 specialistësh të sekretarisë gjyqësore**, të cilët së bashku me **1 specialist protokoll/arkive** do të ngarkohen të përbushin detyrat ligjore të dërgimit të dosjeve të ankimuara pranë Kolegit të Posaçëm të Apelimit.

**5.** Komisioni konstaton nevojën e një specialisti prokurimesh, detyrë të cilën aktualisht e mbulon një nga specialistët e sekretarisë gjyqësore. Për këtë arsy, kërkojmë shtesë në organikë me **1 specialist prokurimesh**.

**6.** Godina ku ushtrohet veprimtaria jonë, përbëhet nga katër kate, tre prej të cilave janë mjedise pune për stafin e Komisionit. Organika ka parashikuar vetëm një punonjës pastrimi. Duke marrë në konsideratë respektimin e kushteve higjieno-sanitare, kërkojmë **shtesë me 1 punonjës pastrimi**.

Për të gjitha arsyet e paraqitur më sipër, ju lutemi të merrni në konsideratë kërkesat tona.

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, thekson edhe një herë përkushtimin ndaj misionit që i është ngarkuar nga Kushtetuta dhe ligji për t'i kthyer besimin publikut në organet e drejtësisë dhe shpreh njëkohësisht vlerësimet më të larta për bashkëpunimin e deritanishëm mes institucioneve tona.

Me konsideratë,

